



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 07.07.2025  
Numër Protokolli: 4895/2025

A.nr.730/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.730/2025, të datës 25.04.2025, të parashtruar nga ankuesi M.R kundër organit të punësimit/ Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpallet jo kompetent* për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.730/2025, të 25.04.2025, të parashtruar nga ankuesi, M.R.

**II.** Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Drejtësisë.

## A r s y e t i m

Ankuesi, M.R. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 25.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e pagës së barabartë sikurse të kolegëve të tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.730/2025, të datës 25.04.2025, të parashtruar nga ankuesi M.R *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi, sipas Kontratës për Marrëdhënien e Punës, të datës 01.11.2022, është i punësuar në pozitën e punës “Vozitës” në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është dëmtuar në pagë dhe është diskriminuar në raport me kolegët e tij që për punën e njëjtë paguhen më shumë, andaj i njëjti kërkon që të aprovohet ankesa dhe të detyrohet organi i punësimit që të nivelizohet koeficienti i pagës së tij, dhe të kompensohet retroaktiv nga data 05.01.2023.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e pozitës së ankuesit të cekur si më lartë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, përkatësisht neni 5 paragrafi 5, ku përcaktohet se: *5.Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike*”. Rrjedhimisht, mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji konstaton se pozita vozitës kategorizohet si pozitë e nëpunësit teknik dhe mbështetës, kështu që, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, rezulton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.730/2025, të datës 25.04.2025 të parashtruar nga ankuesi, M.R.

Andaj, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.730/2025, të datës 25.04.2025.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.730/2025, të datës 25.04.2025, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda t’i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Drejtësisë.

Kështu që thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.730/2025**

**Atdhe GASHI**

---

Procesmbajtës

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

---

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit M.R;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë;
- Komisionit të Ankesave në Ministrinë e Drejtësisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së